



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

MINISTRIA E FINANCAVE/MINISTARSTVO ZA FINANSIJE
MINISTRY OF FINANCE

KB FR Kosovo Board on Standards for Financial Reporting
 BK RF Bordi Kosovar mbi Standardet per Raportim Financiar
 KB FI Kosovski Bord za Standarde Finansijskog Izvestavanja

SKK 12

Tatimet mbi fitimin

Qëllimi

Qëllimi i këtij standardi është që të përshkruaj procedurën kontabël të tatimeve mbi fitimin. Çështja kryesore e kontabilitetit për tatimet mbi fitimin është se si bëhet përlogaritja e efekteve të tatimeve rrjedhëse dhe të ardhshme të:

- (a) rikuperimet (shlyerjeve) e ardhshme të shumës së regjistrimit të pasurive (detyrimeve) të cilat njihen në pasqyrën e bilancit të një ndërmarrjeje.
- (b) transaksioneve dhe ngjarjeve tjera të periudhës kurrenente që njihen në pasqyrën financiare të ndërmarrjes.

Është me rëndësi që me rastin e njohjes së një pasurie apo detyrimi, një ndërmarrje të presë që të rivendosë ose të përcaktojë përfundimisht shumën e regjistrimit të një pasurie apo detyrimi. Nëse është e mundshme që rivendosja pse përcaktimi përfundimtar i shumës së regjistrimit që t'i bëjë pagesat e ardhshme më të mëdha (më të vogla) se sa do të ishin nëse rivendosjet apo përcaktimet e tilla përfundimtare nuk do të kishin pasoja të tatimit, ky standard kërkon që një ndërmarrje të njohë një detyrim të shtyrë tatimor (pasuri të shtyrë tatimore), me përjashtime të caktuara të kufizuara.

Ky standard kërkon nga ndërmarrja të përlogarisë pasojat tatimore të transaksioneve dhe ngjarjeve tjera në mënyrë të njëjtë siç përlogaritet

transaksionet dhe ngjarjet tjera. Prandaj krahas transaksioneve dhe ngjarjeve afariste të pranuar në pasqyrën e të ardhurave, çdo efekt i lidhur me tatimin poashtu pranohet në pasqyrën e të ardhurave. Për transaksionet dhe ngjarjet tjera të pranuar drejtëpërdrejtë në kryegjë, çdo efekt i lidhur me tatimin poashtu pranohet në ekuitet.

Ky standard poashtu ka të bëjë me paraqitjen e tatimeve mbi fitimin në pasqyrat financiare dhe shpalosjen e informatave lidhur me tatimet mbi fitim.

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtim me standardet e kontabilitetit të Kosovës nënkupton se do të ketë raste kur fitimi kontabël dhe fitimi i tatuar do të jenë të ndryshëm. Këto ndryshime janë për shkak të faktit se autoritetet tatimore ndjekin një sistem të ndryshëm të rregullave që të arrijnë deri tek fitimi i tatuar.

Fushëveprimi

1. Ky standard duhet të zbatohet në kontabilitet për tatimet mbi fitim.
1. Ky standard nuk ka të bëjë me metodat e kontabilitetit për grantet qeveritare, që janë diskutuar në SKK 7 “Kontabiliteti për grantet qeveritare dhe shpalosja e ndihmës qeveritare”. Megjithatë, ky standard ka të bëjë me kontabilitetin për ndryshimet e përkohshme që mund të dalin prej granteve të tilla.

Përkufizimet

2. Termat vijues janë përdorur në këtë standard me këto kuptime:

Fitimi kontabël është fitimi ose humbja neto për periudhën para heqjes së shpenzimit të tatimit.

Fitimi i tatueshëm (humbja tatimore) është fitimi (humbja) për periudhë, i përcaktuar në pajtim me rregullat e vendosura nga autoritetet tatimore, sipas të cilave tatimet mbi fitimin janë të pagueshme (rikuperueshme).

Shpenzimi tatimor është shuma totale për periudhën raportuese e shpenzimit kurrent të tatimit dhe e shpenzimi të tatimit të shtyrë.

Tatimi kurrent është shuma e tatimeve të pagueshme në të ardhura (të rikuperueshme) në lidhje me fitimin e tatuar (humbjen tatimore) për një periudhë.

Pasuria e tatimit të shtyrë janë shumat e tatimeve mbi të ardhurat, të rikuperueshme për periudhat e ardhshme në lidhje me ndryshimet e përkohshme të zbritshme.

Detyrimet e tatimit të shtyer janë shumat e tatimeve mbi fitimin, të pagueshme për periudhat e ardhshme në lidhje me ndryshimet e përkohshme të zbritshme.

Ndryshimet e përkohshme janë ndryshimet midis shumës së regjistrimit të një pasurie ose detyrimi në pasqyrën e bilancit dhe bazës së tyre tatimore. Ndryshimet e përkohshme mund të jenë gjithashtu:

- (a) **Ndryshimet e përkohshme të tatueshme**, që janë ndryshimet e përkohshme që do të rezultojnë me shumat e tatuara gjatë përcaktimit të fitimit të tatuara (humbjes tatimore) të periudhave të ardhme kur shuma e regjistrimit të pasurisë ose detyrimin është rikuperuar ose përcaktuar përfundimisht.
- (b) **Ndryshimet e përkohshme të zbritshme**, janë ndryshimet e përkohshme që rezultojnë me shumat që janë të zbritshme gjatë përcaktimit të fitimit të tatuara (humbjes tatimore) të periudhave të ardhshme kur shuma e regjistrimit të pasurisë ose detyrimin është rikuperuar ose përcaktuar përfundimisht.

Baza tatimore. Baza e tatimit e një pasurie ose detyrimi është shuma që atribuohet (shoqërohet) për atë pasuri ose detyrim për qëllime të tatimit.

Baza tatimore

- 4. Baza tatimore e një pasurie është shuma që do të jetë e zbritshme për qëllime tatimi kundrejtë çfarëdo dobishë ekonomike të tatueshme që do të derdhen në një ndërmarrje kur ajo të rikuperojë shumën e regjistrimit të pasurisë. Nëse këto dobi ekonomike nuk do të jenë të tatueshme, baza tatimore e pasurisë është e barabartë me shumën e regjistrimit.

Shembujt:

- (a) Një makinë kushton 100,000 DM. Për qëllime tatimi, amortizimi prej 30,000 DM ka qenë zbritur në periudhën kurrente dhe paraardhëse dhe kostoja e mbetur do të zbritet nga tatimi në periudhat e ardhshme. Baza tatimore e makinës tani është 70,000 DM.
- (b) Kamata e arkëtueshme ka shumë të regjistruar prej 4,000 DM. E hyra e lidhur me kamatën është përfshirë në fitimin e tatuara. Baza tatimore e kamatës së arkëtuar është 4,000 DM.
- (c) Kredia e arkëtueshme ka shumë të regjistrimit prej 3,000 DM. Pagesa e kredisë nuk do të ketë pasoja tatimore. Baza tatimore e kredisë është 3,000 DM.

5. Baza tatimore e detyrimit është shuma e regjistrimit, minus çdo shumë që do të jetë e zbritshme për qëllime tatimi në lidhje me detyrimin përkatës në periudhat e ardhshme. Në rastin e të hyrave që janë arkëtuara në avans, baza tatimore e detyrimit rezultues është shuma e regjistrimit, minus çdo shumë e së hyrës që nuk do të jetë e tatueshme në periudhat e ardhshme.

Shembujt:

1. Detyrimet kurrente përfshijnë shpenzimet e përlogaritura me shumë të regjistruar prej 1,000 DM. Shpenzimet përkatëse tanimë janë zbritur për qëllime tatimi. Baza tatimore e shpenzimeve të përlogaritura është 1,000 DM.
2. Detyrimet kurrente përfshijnë gjobat dhe dënimet e përlogaritura me shumë të regjistruar prej 2,000 DM. Gjobat dhe dënimet nuk zbriten për qëllim tatimi. Baza tatimore e gjobave dhe dënimeve të përlogaritura është 2,000 DM.
3. Detyrimi ushtrimor përfshin qiranë e arkëtuar në avans me shumë të regjistruar prej 6,000 DM. E hyra përkatëse do të tatóhet sapo të jetë zvogëluar detyrimi dhe sapo të njihet e hyra e shtyrë. Baza tatimore e qirasë së arkëtuar në avans është 6,000 DM.

Njohja e detyrimeve të tatimit kurrent dhe të pasurive të tatimit kurrent

6. Tatimi kurrent për periudhat kurrente dhe paraardhëse duhet, për aq sa nuk është paguar, të njihet si detyrim. Nëse shuma tashmë e paguar në lidhje me periudhat kurrente dhe paraardhëse tejkalon shumën e borxhit për këto periudha, teprica duhet të njihet si një pasuri.
7. Dobia lidhur me humbjen tatimore që mund të regjistrohet prapa për rikuperuar tatimin kurrent të periudhës paraardhëse duhet të njihet si një pasuri. Kur humbja tatimore përdoret për të rikuperuar tatimin kurrent të periudhës paraardhëse, ndërmarrja e njeh dobinë si një pasuri për periudhën në të cilën humbja tatimore ndodh sepse është e mundshme që dobia do të derdhet në ndërmarrje dhe se dobia mund të matet me besueshmëri.

Njohja e detyrimeve të tatimit të shtyrë dhe pasurisë së tatimit të shtyrë

Ndryshimet e përkohshme të tatueshme

8. Është e qenësishme në njohjen e një pasurie që shuma bartëse të kthehet në formë të dobisë ekonomike që derdhet në ndërmarrje në periudhat e ardhshme. Kur shuma e regjistruar e pasurisë e tejkalon bazën e saj tatimore, shuma e dobisë së tatueshme ekonomike të do të tejkalojë shumën që lejohet si zbritje për qëllime tatimi. Ky ndryshim është ndryshimi i përkohshëm i tatueshëm dhe obligim për të paguar tatimin rezultues mbi fitimin në periudhat e ardhshme si detyrim i tatimit të shtyrë. Sapo ndërmarrja të ketë rikuperuar shumën e regjistrimit të pasurisë, ndryshimi i tatimit të shtyrë do të rikuperohet dhe ndërmarrja do të ketë fitim të tatuar. Kjo e bën të mundshëm që dobia ekonomike do të rrjedh prej ndërmarrjes në formë të pagesës së tatimit. Prandaj, ky standard kërkon njohjen e të gjitha detyrimeve të tatimeve të shtyera.

Shembull:

Një pasuri që kushton 150,000 DM ka amortizim të akumuluar prej 50,000 dhe shumë të regjistruar prej 100,000 DM. Amortizimi kumulativ për qëllime tatimi është 90,000 DM dhe shkalla e tatimit është 25%. Amortizimi i tatimit prej 90,000 është më i lartë se amortizmi i akumuluar në kontabilitet prej 50,000. Baza tatimore e pasurisë është 60,000 DM (kostoja prej 150,000 minus amortizimi kumulativ i tatimit prej 90,000). Për të rikuperuar shumën e regjistrimit prej 100,000, ndërmarrja duhet të fitojë të ardhura të tatueshme prej 100,000, por do të ketë mundësi të zbres vetëm amortizimin e tatimit prej 60,000. Rrjedhimisht, ndërmarrja do të paguaj tatimin mbi fitim prej 10,000 DM (40,000 me 25%) kur kthen shumën e regjistrimit të pasurisë. Ndryshimi midis shumës së regjistrimit prej 100,000 dhe bazës tatimore prej 60,000 është ndryshim i përkohshëm i tatueshëm prej 40,000. Prandaj, ndërmarrja njihet detyrimin e tatimit të shtyrë prej 10,000 (40,000 me 25%) duke përfaqësuar tatimin mbi fitimin që do ta paguaj kur e rikuperon shumën e regjistrimit të pasurisë.

9. Disa ndryshime të përkohshme dalin kur e ardhura ose shpenzimi përfshihet në fitimin kontabël në një periudhë por përfshihet si fitim i tatueshëm për periudhën tjetër. Këto ndryshime të përkohshme shpesh përshkruhen si ndryshime kohore. Ndryshimi i përkohshëm i këtij lloji është ndryshim i përkohshëm i tatuar dhe do të rezultojë me detyrime të tatimit të shtyrë.

Shembull:

Amortizimet e përdorura për përcaktimin e fitimit të taueshëm (humbjes tatimore) mund të ndryshojnë prej atyre të përdorura në përcaktimin e fitimit kontabël. Ndryshimi i përkohshëm është ndryshimi në mes të shumës së regjistrimit të asaj pasurie dhe bazës së saj tatimore. Baza tatimore e pasurisë është kostoja origjinale e pasurisë pa të gjitha zbritjet që lejohen nga autoritetet përkitazi me atë pasur, në përcaktimin e fitimit të taueshëm të periudhës kurrenente dhe paraardhëse. Ndryshimi i përkohshëm tatimor vjen, dhe rezulton në një pasuri të tatimit të shtyrë, kur amortizimi tatimor përshejtohet (nëse amortizimi tatimor është më i ngadalshëm se sa amortizimi kontabël, vjen deri të një ndryshim i përkohshëm i zbritshëm, dhe rezulton me një pasuri të tatimit të shtyrë).

10. Ndryshimet e përkohshme poashtu dalin kur baza tatimore e një pasurie ose detyrimi ndryshon me njohjen fillestare nga shuma fillestare e regjistruar. Për shembull, kur një ndërmarrje përfiton nga granti qeveritar i patatuar lidhur me një pasuri. Për qëllime të kontabilitetit, granti zvogëlon shumën e regjistrimit të pasurisë, derisa për qëllime tatimi nuk zbritet. Prandaj, shuma e regjistrimit është më e vogël se baza tatimore.

Pasuria e regjistruar në vlerë fer

11. Standardet e kontabilitetit të Kosovës lejojnë që pasuritë e caktuara të regjistrohen në vlerën fer ose të rivlerësohen (shih SKK 3 "Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet"). Rivlerësimi i një pasurie nuk ndikon në fitimin e taueshëm në periudhën e rivlerësimit dhe rrjedhimisht, baza tatimore e pasurisë nuk është e korigjuar. Megjithatë, rikuperimi i shumës së regjistrimit në të ardhmen do të rezultojë me një rrjedhë të taueshme të dobive ekonomike që do të derdhen në ndërmarrje dhe shuma që do të zbritet për qëllime tatimi do të ndryshoj nga shuma e dobive ekonomike. Ndryshimi midis shumës së regjistrimit të pasurisë së rivlerësuar dhe bazës së saj tatimore është ndryshim i përkohshëm dhe e shton detyrimin apo pasurinë e shtyrë tatimorë. Kjo është e vërtetë edhe nëse ndërmarrja nuk mendon ta heq nga përdorimi pasurinë. Në raste të tilla, shuma e rivlerësuar e regjistrimit të pasurisë do të rikuperohet nëpërmes përdorimit dhe kjo do të krijojë të ardhura të taueshme që tejkalojnë amortizimin që do të jetë i lejueshëm për qëllime tatimi në periudhat e ardhshme.

Njohja fillestare e pasurisë ose e detyrimit

12. Një ndryshim i përkohshëm mund të del me rastin e njohjes fillestare të pasurisë ose të detyrimit. Kjo ndodh kur ekziston ndryshimi midis shumës së regjistrimit të një pasurie ose detyrimi në pasqyrën e bilancit dhe në

bazën tatimore të tyre. Metoda kontabël për një ndryshim të përkohshëm të tillë varet nga natyra e transaksionit që shpie në njohjen fillestare të pasurisë ose të detyrimit.

- (a) Nëse transaksioni ndikon ose në fitimin kontabël ose në fitimin e tatueshëm, një ndërmarrje njihet si rezultat i detyrimit ose pasurisë të shtyrë tatimore dhe njihet si shpenzimi i tatimit të shtyrë rezultues ose të të ardhurës së tatimit të shtyrë rezultuese në pasyren e bilancit.

Shembull

Ndërmarrja paguan qiranë prej 5,000 në avans për periudhat e ardhshme të qirasë. Këto 5,000 janë plotësisht të zbritshme për qëllime tatimi kur të jenë paguar. Tarifa tatimore është 25%. Për qëllime kontabël, shpenzimi i qirasë njihet gjatë periudhave të ardhshme të qirasë. Një shpenzim i tatimit të shtyrë prej 1,250 ($5000 \times 25\%$) njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe një detyrim i tatimit të shtyrë prej 1,250 njihet në pasqyrën e bilancit.

- (b) Nëse transaksioni nuk ndikon as në fitimin kontabël ose fitimin e tatueshëm, ndërmarrja nuk njihet si rezultat i detyrimit apo pasurisë së tatimit të shtyrë, as në njohjen fillestare e as në të ardhmen. Gjithashtu, ndërmarrja nuk njihet si ndryshim i pasurisë së detyrimit apo pasurisë së tatimit të shtyrë të panjohur ose pasurisë së pasurisë së jetë amortizuar.

Shembull

Ndërmarrja ka ndërmend ta përdor një pasuri që kushton 10,000 DM gjatë tërë kohëzgjatjes së jetës së përdorimit të saj prej pesë vjetëve dhe pastaj e bën heqjen e saj prej përdorimit me një vlerë të mbetur zero. Shkalla tatimore është 40%. Amortizimi i pasurisë nuk është i zbritshëm për qëllime tatimi. Me heqjen nga përdorimi, çdo përfitim kapital nuk do të ishte i tatueshëm dhe çdo humbje kapitale nuk do të ishte e zbritshme. Sapo të ketë rikuperuar shumën e regjistrimit të pasurisë, ndërmarrja do të fitoj të ardhura të tatueshme prej 10,000 DM dhe do të paguaj tatim prej 4,000 DM. Ndërmarrja nuk njihet si rezultat i detyrimit e tatimit të shtyer rezultues prej 4,000 DM sepse kjo rezulton prej njohjes fillestare të pasurisë.

- (c) Një rast kur pasuria e tatimit të shtyrë vjen me njohjen fillestare të një pasurie është kur granti qeveritar i patatueshëm lidhur me një

pasuri është zbritur për të arritur në shumën e regjistrimit të pasurisë, por, për qëllime tatimi, nuk është zbritur nga shuma e amortizueshme e pasurisë (bazës së saj tatimore). Shuma e regjistrimit të pasurisë është më e ulët se baza tatimore e saj dhe kjo rezulton në ndryshimin e përkohshëm të zbritur. Ndërmarrja nuk njih pasurinë e tatimit të shtyrë rezultues.

Shembull

Një ndërmarrje pranon një grant të patatueshëm për një pasuri që kushton 30,000 DM. Për qëllime tatimi, amortizimi nuk është i zbritshëm. Për qëllime kontabël, e hyra nga granti është njohur në periudha të njëjta dhe shumat si shpenzim i amortizueshëm. Ndikim neto në pasqyrën e të ardhurave dhe në të ardhurat e tatueshme është zero, pra pasuria e tatimit të shtyrë nuk është njohur.

Ndryshimet e përkohshme të zbritshme

13. Një pasuri e tatimit të shtyrë duhet të njihet për të gjitha ndryshimet e përkohshme të zbritshme deri në atë shkallë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë në disponim kundrejtë të cilit ndryshimi i përkohshëm i zbritshëm mund të përdoret.
14. Është imanente në njohjen e detyrimit që shuma e regjistrimit do të përcaktohet përfundimisht në periudhat e ardhshme përmes një rrjedhe dalëse nga ndërmarrja të burimeve të trupëzuara në dobi ekonomike. Kur burimet dalin nga ndërmarrja, një pjesë e tyre ose të gjitha shumat e tyre mund të jenë të zbritshme në caktimin e fitimit të tatueshëm për një periudhë të mëvonshme se sa periudha në të cilën detyrimi është njohur. Në raste të tilla, ndryshimi i përkohshëm ekziston midis shumës së regjistrimit të detyrimit dhe bazës së tij tatimore. Prandaj, pasuria e tatimit të shtyrë rrjedh duke u bazuar në tatimet mbi fitimin që do të rikuperohen në periudhat e ardhshme kur një pjesë e detyrimit është lejuar si zvogëlim në caktimin e fitimit të tatueshëm. Ngjashëm, nëse shuma e regjistrimit të pasurisë është më e vogël se baza e tij tatimore, ndryshimet e shtojnë pasurinë e tatimit të shtyrë në lidhje me tatimin mbi fitimin që do të kthehet në periudhat e ardhshme.

Shembull

Ndërmarrja e një detyrimin prej 10,000 DM për humbjen e vlerësuar lidhur me çështjet e pazgjidhura gjyqësore. Për qëllime tatimi, shpenzimi nuk do të jetë i zbritshëm derisa ndërmarrja nuk paguan përcaktimin përfundimtar. Tarifa tatimore është 25%. Baza tatimore e detyrimit është zero (shuma e regjistrimit prej 10,000, minus shuma që do të jetë e zbritshme për qëllime tatimi në lidhje me atë detyrim në periudhat e ardhshme). Me përcaktimin përfundimtar të detyrimit për shumën e regjistrimit të tij, ndërmarrja do të zvogëlojë fitimin e tatueshëm në të ardhmen në një shumë prej 10,000 dhe për këtë arsye, zvogëlon pagesën e saj të tatimit në të ardhmen për 2,500 (10,000 me 25%), duke pasë parasysh mundësinë që ndërmarrja do të fitojë fitim tatueshëm të mjaftueshëm në periudhat e ardhshme për të përfituar nga zvogëlimi në pagesat e tatimit.

15. Pasuria e caktuara si patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet mund të regjistrohen në vlerë fer, ose mund të rivlerësohen pa korigjim ekuivalent të bërë për qëllime tatimi. Ndryshimet e përkohshme të zbritshme rrjedhin nëse baza tatimore e pasurisë tejkalon shumën e regjistrimit të saj.
16. Kthimi prapa i ndryshimeve të përkohshme të zbritshme rezulton me zbritjet në përcaktimin e fitimit të tatueshëm në periudhat e ardhshme. Sidoqoftë, dobitë ekonomike në formë të zvogëlimit të pagesës së tatimit do të rrjedhin në ndërmarrje vetëm nëse ka fitim të mjaftueshëm që tatóhet kundrejtë të cilit zbritjet mund të barazohen. Prandaj, ndërmarrja një pasurinë e tatimit të shtyrë vetëm kur është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë në disponim kundrejt të cilit ndryshimet e përkohshme të zbritshme mund të përdoren.

Humbjet tatimore të papërdorura dhe kreditë tatimore të papërdorura

17. Një pasuri e tatimit të shtyrë duhet të njihet për regjistrim të humbjet tatimore të papërdorura deri në atë masë që është më se e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në disponim kundrejt të cilit humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren.
18. Kriteret për njohjen e pasurisë së tatimit të shtyrë që rrjedh nga regjistrimi i humbjeve tatimore të papërdorura janë të njëjta si kriteret e njohjes së pasurisë së tatimit të shtyrë që rrjedh nga ndryshimet e përkohshme të zbritshme. Megjithatë, ekzistimi i humbjes tatimore të papërdorur është evidencë e fortë se fitimi i tatueshëm në të ardhmen mund të mos jetë në disponim. Prandaj, kur një ndërmarrje ka një histori të humbjeve në kohë të fundit, ndërmarrja një pasurinë e tatimit të shtyrë që rrjedh prej humbjeve tatimore të papërdorura vetëm deri në atë masë ku ndërmarrja ka ndryshime të përkohshme të tatueshme të mjaftueshme ose ekziston evidenca tjetër bindëse se fitimi i tatueshëm i mjaftueshëm do të jetë në

- disponim kundrejt të cilit humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren nga ndërmarrja. Në rrethana të tilla kërkohet, shpалosja e shumës së pasurisë së tatimit të shtyrë dhe të natyrës e evidencës që përkrah njohjen e saj.
19. Një ndërmarrje duhet të konsideroj kriteret vijuese në vlerësimin e mundësisë që fitimi i tatueshëm do të jetë në disponim kundrejt të cilit humbjet tatimore të papërdorura mund të përdoren:
- (a) Qoftë nëse duket se ndërmarrja do të ketë fitim të tatueshëm para se të skadoj humbja tatimore e papërdorur
 - (b) Qoftë kur humbja tatimore e papërdorur rezulton nga shkaqe të identifikueshme që vështirë se do të përsëriten.
20. Deri në nivelin që nuk duket se fitimi i tatueshëm do të jetë në disponim kundrejt të cilit humbja tatimore e papërdorur mund të përdoret, pasuria e tatimit të shtyrë nuk njihet.

Rivlerësimi i pasurisë së mosnjohur të tatimit të shtyrë

21. Në çdo datë të pasqyrës së bilancit, ndërmarrja rivlerëson pasurinë e tatimit të shtyrë e të mosnjohur. Ndërmarrja njih pasurinë e tatimit të shtyrë e të mosnjohur më parë, deri në atë masë ku bëhet e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të lejoj pasurinë e tatimit të shtyrë që të rikuperohet. Për shembull, përmirësimi i kushteve të tregëtisë mund ta bëjë atë më të mundshëm se ndërmarrja do të jetë në gjendje që të krijoj fitim të tatueshëm të mjaftuar në të ardhmen, në mënyrë që pasuria e tatimit të shtyrë të njihet.

Matja

22. Detyrimet kurrenre (pasuria) të tatimit për periudhat kurrenre dhe paraardhëse duhet të maten në shumën që pritet të paguhet për (rikuperohet nga) autoritetet tatimore, duke përdor tarifën e tatimit (dhe ligjet e tatimit) që janë miratuar me ligj ose miratuar pavarësisht nga data e pasqyrës së bilancit.
23. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit të shtyrë duhet të maten me tarifë tatimore që pritet të zbatohet për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi përcaktohet përfundimisht, bazuar në tarifën e tatimit (dhe ligjet e tatimit) që janë miratuar me ligj ose miratuar pavarësisht nga data e pasqyrës së bilancit.
24. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit zakonisht maten duke përdorur tarifën e tatimit (dhe ligjet e tatimit) që janë miratuar.

25. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit të shtyrë nuk duhet të zbriten.
26. Shuma e regjistrimit të pasurisë së tatimit të shtyrë duhet të rishqyrtohet në çdo datë të pasqyrës së bilancit. Ndërmarrja duhet të zvogëlojë shumën e regjistrimit të pasurisë së tatimit të shtyrë deri në atë masë që më të mos jetë e mundshme që fitimi i tatueshëm e i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion për të lejuar dobinë e një pjese ose të gjithë pasurisë së tatimit të shtyrë . Çdo zbritje e tillë duhet të rikuperohet deri në atë masë kur bëhet e mundshme që fitimi i tatueshëm e i mjaftueshëm do të jetë në dispozicion .

Njohja e tatimit kurrent dhe të shtyrë

27. Përlllogaritja e efekteve të tatimit kurrent dhe të shtyrë të një transaksioni ose ngjarje tjetër duhet të jenë konsekuente me përlllogaritjen për vet transaksionin ose ngjarjen.

Pasqyra e të ardhurave

28. Tatimi kurrent dhe i shtyrë duhet të njihet si e ardhur ose si një shpenzim dhe të përfshihet në fitimin ose humbjen neto për periudhë, përveç deri në atë masë ku tatimi del nga transaksioni ose ngjarja që është njohur në të njëjtën periudhë ose periudhë të ndryshme, drejtëpërdrejt në ekuitet.
29. Shumica detyrimeve të tatimit të shtyrë dhe pasurisë së tatimit të shtyrë dalin kur e ardhura ose shpenzimi përfshihet në fitimin e përlllogaritur në një periudhë, por është përfshirë në fitimin e tatueshëm (humbja tatimore) në periudha të ndryshme. Tatimi i shtyrë rezultues njihet në pasqyrën e bilancit.
30. Shuma e regjistrimit të detyrimeve dhe pasurisë së tatimit të shtyrë mund të ndryshoj edhe pse nuk ekziston ndryshim në shumën e ndryshimeve të përkohshme të ndërlidhura. Kjo mund të rezultoj, për shembull, nga:
 - (a) ndryshimi në tarifën e tatimit ose ligjet tatimore
 - (b) rivlerësimi i rikuperimit të pasurisë së tatimit të shtyrë
31. Tatimi i shtyrë rezultues njihet në pasqyrën e bilancit, përveç deri në nivelin kur lidhet me çështjet që më parë janë ngarkuar ose kredituar në ekuitet.

Zërat e kredituar ose të ngarkuar drejtëpërdrejt në ekuitet

32. Tatimi kurrent dhe i shtyrë duhet të ngarkohet ose kreditohet drejtpërdrejt në ekuitet nëse tatimi lidhet me zërat që janë kredituar ose ngarkuar, në periudhë të njëjta ose të ndryshme, drejtpërdrejt në ekuitet.
33. Standardet e kontabilitetit të Kosovës kërkojnë që çështjet vijuese të kreditohen ose ngarkohen drejtpërdrejt në ekuitet:
- (a) Ndryshimi në shumën e regjistrimit të patundshmërive, impianteve dhe pajisjeve për shkak të rivlerësimit (shih SKK 3 “Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet”)
 - (b) Transferimi i bilancit të rivlerësuar pozitiv të pasurisë së rivlerësuar me heqjen nga përdorimi (shih SKK 3 “Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet”)
34. SKK 3 “Patundshmëritë, impiantet dhe pajisjet” saktëson se gjatë shitjes së pasurisë së rivlerësuar bilanci përkatës në konton e bilancit pozitiv duhet të transferohet në fitimet e pashpërndara. Shuma e transferuar është neto e çdo tatimi të shtyrë përkatës.

Prezantimi

Pasuritë tatimore dhe detyrimet tatimore

35. Pasuritë tatimore dhe detyrimet tatimore duhet të prezantohen ndarazi nga pasuritë dhe detyrimet tjera në pasqyrën e bilancit. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit të shtyrë duhet të dallohen nga pasuritë dhe detyrimet e tatimit kurrent.
36. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit të shtyrë duhet të klasifikohen si pasuri dhe detyrim jo kurrent në pasqyrat financiare.

Kundërpeshimi

37. Ndonëse pasuritë dhe detyrimet e tatimit kurrent pranohen dhe maten ndarazi barazimi i tyre bëhet në pasqyrën e bilancit sipas kriterëve të caktuara. Pasuritë dhe detyrimet e tatimit kurrent legalisht mund të barazohen kur tatimet janë obligim ndaj autoritetit të njëjtë tatimor dhe autoriteti tatimor lejon ndërmarrjen të bëjë ose të pranoj një pagesë të vetme neto. Si rezultat, pasqyra e bilancit do të pasqyroj shumën neto si borxh ndaj autoritetit tatimor. Shumat e pasurisë tatimore dhe detyrimit tatimor që janë në vlerë neto do të shpalosen si shënim në pasqyrat financiare

Shpenzimi tatimor

38. Shpenzimi tatimor lidhur me fitimin ose humbje nga aktivitetet e rregullta duhet të paraqitet në ballinën e pasqyrës së bilancit.

Shpalosja

39. Përbërësit kryesor të shpenzimit të tatimit duhet të shpalosen ndarazi si shënim.
40. Përbërësit e shpenzimit tatimor mund të përfshijnë:
- (a) Shpenzimin tatimor kurrent
 - (b) Shumën e shpenzimit (të ardhurës) të tatimit të shtyrë lidhur me prejardhjen dhe kthimin e ndryshimeve të përkohshme
 - (c) Shumën e shpenzimit (të ardhurës) të tatimit të shtyrë lidhur me ndryshimet në shkallët tatimore ose imponimit të tatimeve të reja
 - (d) Shumën e shpenzimit (të ardhurës) tatimore lidhur me gabimet fundamentale që përfshihen në caktimin e fitimit ose humbjes neto për periudhën në pajtim me SKK 5 “Fitimi ose humbja neto për periudhën, zërat e jashtëzakonshëm, gabimet fundamentale, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe ndryshimet në politikat kontabël”
41. Shpalosjet e caktuara tatimore ju mundësojnë përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë nëse marrëdhënia ndërmjet shpenzimit (të ardhurës) tatimor dhe fitimit kontabël është e jashtëzakonshme dhe për t'i kuptuar faktorët e rëndësishëm që mund të ndikojnë në atë marrëdhënie në të ardhmen. Mbi raportin ndërmjet shpenzimit (të ardhurës) tatimor dhe të fitimit kontabël mund të ndikojnë faktorët siç janë të hyrat e liruar nga tatimi, shpenzimet që nuk janë të zbritshme në caktimin e fitimit të tatuar dhe efekti i humbjeve tatimore.
42. Çështjet në vazhdim duhet të shpalosen ndarazi:
- (a) Tatimi i përmbledhur kurrent dhe i shtyrë lidhur me zërat që ngarkohen ose kreditohen drejtëpërdrejt në ekuitet
 - (b) Shpenzimi tatimor lidhur me zërat e jashtëzakonshëm të njohur gjatë periudhës
 - (c) Një spjegim të marrëdhënies midis shpenzimit (të ardhurës) tatimor dhe fitimit kontabël të prezentuar si barazim numerik midis shpenzimit (të ardhurës) tatimor dhe të produktit të fitimit kontabël të shumëzuar me shkallën (at) tatimore të zbatueshme

- (d) Një spjegim të ndryshimit në shkallën (at) tatimore të zbatueshme krahasuar me periudhën e mëparshme kontabël
43. Ndërmarrja duhet të shpalos shumën e pasurisë së tatimit të shtyrë dhe natyrën e evidencës që mbështet njohjen e tij kur përdorimi i pasurisë së tatimit të shtyrë varet nga fitimet e tatueshme në të ardhmen dhe kur ndërmarrja ka pasur humbje ose në periudhën paraardhëse ose atë kurrenente.
44. Ndërmarrja duhet të shpalos çdo pasuri ose detyrim tatimor të mundshëm në pajtim me SKK 17 "Provizionet, detyrimet kontingjente dhe pasuritë kontingjente". Pasuritë ose detyrimet kontingjente në lidhje me tatimin mund të dalin nga mosmarrëveshjet e pazgjidhura me organet tatimore.

Data e hyrjes në fuqi

45. Ky standard do të hyjë në fuqi për pasqyrat financiare që u përkasin periudhave prej 1 janari 2002 apo më pas. Rekomandohet zbatimi i mëhershëm i këtij standardi.

Shtojca

Shtojca është vetëm ilustrim dhe nuk është pjesë e standardit. Qëllimi i shtojcës është për të ilustruar zbatimin e standardit për të ndihmuar në sqarimin e kuptimit të tij.

Shembulli i parë

Ndërmarrja ka fitim financiar të përlogaritur paratimor prej 400,000 DM për 2002. Në fillim të 2003, ndërmarrja ka filluar të përdor shkallë të ndryshme të amortizimit për qëllime financiare dhe të përlogaritjes së tatimit. Shpenzimet e amortizimit për vitin 2003 për qëllime të raportimit financiar janë 25,000 dhe amortizimi me qëllim të raportimit të tatimit është 30,000. Norma e tatimit është 25%.

Fitimi i llogaritur paratimor	<u>400,000</u>
Ndryshimi i përkohshëm-amortizimi	5,000
E ardhura e tatueshme	<u>395,000</u>
Tatimi ushtrimor i pagueshëm	395,000 x 25% = 98,750
Detyrimi tatimit të shtyrë	5,000 x 25% = 1,250
Totali i rezervës tatimore	100,000

Në pasqyrat financiare do të njihen zërat vijues:

Detyrimi i tatimit të shtyrë prej 1,250

Shpenzimet tatimore të periudhës kurrente 100,000

Të ardhurat tatimore të pagueshme kurrente 98,750

Shembulli i dytë

Raportet financiare të 2001 për një ndërmarrje përfshijnë shpenzimin aktual prej 8,000 DM për një humbje të pritur nga gjyqi që nuk do të vendoset deri në 2002. Udhëzimi tatimor nuk lejon që humbja të zbritet për qëllime tatimi deri sa të paguhet. Fitimi financiar paratatimor i ndërmarrjes për 2001 është 150,000. Tarifa tatimore është 25%.

Fitimi kontabël paratatimor	<u>150,000</u>
Ndryshimi i përkohshëm-gjyqi	8,000
E ardhura e tatueshme	<u>158,000</u>

Detyrimi i tatueshëm kurrent	$158,000 \times 25\% = 39,500$
Detyrimi i tatimit të shtyrë	$8,000 \times 25\% = 2,000$
Totali i provizioneve tatimore	37,500

Në raportet financiare do të njihen zërat vijues:

Pasuria e tatimit të shtyrë prej 2,000

Shpenzimet tatimore të periudhës kurrente 37,500

Të ardhurat tatimore të pagueshme kurrente 39,500